

E DREJTA PËR INFORMIM

8 Rekomandime në fushën e të Dhënave të Hapura dhe Ripërdorimit të Informacionit të Sektorit Publik

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar dhe publikuar 8 rekomandime në fushën e të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik, drejtuar institucioneve publike në fushën e mjedisit, administrimit të burimeve natyrore dhe mbrojtjes civile.

Këto rekomandime synojnë forcimin e zbatimit të kuadrit ligjor për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, duke nxitur institucionet publike të garantojnë disponueshmërinë, aksesueshmërinë dhe përdorshmërinë e të dhënave që prodhojnë ose administrojnë në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Rekomandimet e miratuara janë:

- Rekomandimi nr. 34/2026 – Ministria e Mjedisit;
- Rekomandimi nr. 35/2026 – Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”;
- Rekomandimi nr. 36/2026 – Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Rekomandimi nr. 37/2026 – Agjencia Kombëtare e Pyjeve;
- Rekomandimi nr. 38/2026 – Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Rekomandimi nr. 47/2026 – Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Rekomandimi nr. 48/2026 – Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- Rekomandimi nr. 49/2026 – Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Nëpërmjet këtyre rekomandimeve, Zyra e Komisionerit synon gjithashtu të nxisë një qasje më proaktive nga institucionet e sektorit publik, duke e konsideruar informacionin jo vetëm si një burim transparence dhe llogaridhënieje, por edhe si një burim me vlerë për shoqërinë, kërkimin, inovacionin dhe zhvillimin ekonomik.

Dokumentet e plota të rekomandimeve janë të publikuara në [faqen zyrtare të Komisionerit](#).

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:



Vendimmarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) gjatë muajit korrik 2026 ka dhënë 5 vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Sipas Vendimit nr. 28 datë 27.07.2026, Zyra e Komisionerit ka pranuar ankesën ndaj autoritetit publik “Bashkia Kolonjë” (në vijim, “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës për informacion të datës 11.05.2026, depozituar pranë Autoritetit Publik, kishte kërkuar informacion dhe dokumentacion për periudhën 2020–2025 në lidhje me fondet dhe buxhetet e alokuara për kulturën, aktivitetet dhe projektet kulturore të organizuara ose të mbështetura financiarisht nga bashkia, institucionet kulturore në varësi të saj dhe strukturat përgjegjëse për kulturën. Gjithashtu, kërkesa përfshinte informacion mbi fondet e përdorura për restaurimin dhe rehabilitimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, strategjitë dhe planet lokale në fushën e kulturës, konsultimet publike, hapësirat dhe infrastrukturën e përdorur për aktivitetet kulturore, të ardhurat e institucioneve kulturore, si dhe aktivitetet, investimet dhe infrastrukturën kulturore të shpërndara sipas njësive administrative.

Në mungesë të një përgjigjeje nga Autoriteti Publik, ankuesja iu drejtua Zyrës së Komisionerit, duke pretenduar cenimin e së drejtës për informim dhe duke kërkuar urdhërimin e tij për vënien në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar.

Pas shqyrtimit paraprak, Zyra e Komisionerit konstatoi se ankesa përmbushte kriteret formale të përcaktuara në nenin 24 të LDI-së dhe, në zbatim të parimit të procesit të rregullt administrativ, i kërkoi Autoritetit Publik të informonte mbi trajtimin e kërkesës për informacion dhe disponimin e dokumentacionit të kërkuar. Pavarësisht kërkesës së Zyrës së Komisionerit, Autoriteti Publik nuk ndërmoi masa për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë shqyrtimit, Komisioneri vlerësoi se informacioni i kërkuar përmbushte kriteret e informacionit publik, në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, pasi lidhej me të dhëna dhe dokumentacion të krijuar ose administruar gjatë ushtrimit të funksioneve publike. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik, si organ i njësive së qeverisjes vendore, përbën autoritet publike, në kuptim të LDI-së dhe, për rrjedhojë, ka detyrimin ligjor të garantojë aksesin në informacionin që prodhon ose administron.

Vendimmarrja e Komisionerit

Vendim Nr. 23 - Bashkia Krujë

Vendim Nr. 24 - Agjencia e

Zhvillimit të Territorit

Vendim Nr. 25 - Ministria e

Ekonomisë dhe Inovacionit

Vendim Nr. 27 - Bashkia Fier

Vendim Nr. 28 - Bashkia Kolonjë

Komisioneri theksoi se informacioni i kërkuar lidhej drejtpërdrejt me përdorimin e fondeve publike dhe veprimtarinë e Autoritetit Publik në sektorin e kulturës, duke përbërë informacion me interes publik. Vënia në dispozicion e këtij informacioni kontribuon në forcimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies së autoriteteve publike dhe i mundëson publikut ushtrimin efektiv të së drejtës për informim.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit rikujtoi se, në rast se ndonjë pjesë e informacionit të kërkuar i nënshtrohet një kufizimi të parashikuar nga LDI, Autoriteti Publik duhet të vërë në dispozicion pjesën tjetër të informacionit dhe të përcaktojë qartë pjesët e kufizuara dhe bazën ligjore të kufizimit, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI-së.

Për këto arsye, Komisioneri pranoi ankesën ndaj Autoritetit Publik dhe urdhëroi këtë të fundit të vinte në dispozicion të ankueses informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për periudhën 2020–2025, lidhur me buxhetet dhe fondet për kulturën, aktivitetet dhe projektet kulturore, institucionet dhe punonjësit e angazhuar në këtë fushë, ndërhyrjet në objektet e trashëgimisë kulturore, strategjitë dhe planet lokale, konsultimet publike, infrastrukturën kulturore, të ardhurat e institucioneve kulturore dhe shpërndarjen e aktiviteteve e investimeve kulturore sipas njësive administrative.


Vendimi mund të lexohet i plotë në faqen e Zyrës së Komisionerit.

Vijojnë përgatitjet për konferencën vjetore të ICIC

Në cilësinë e Presidentit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, drejtoi mbledhjen e katërt plenare të Komitetit Ekzekutiv, gjatë së cilës u shqyrtuan çështje kyçe që lidhen me organizimin e konferencës së ardhshme, qeverisjen e organizatës dhe iniciativat strategjike të ICIC.

Gjatë mbledhjes u raportua mbi ecurinë e përgatitjeve për konferencën vjetore, ku deri më tani raportohet për një pjesëmarrje të kënaqshme nga shumë vende anëtare të organizatës. U diskutua gjithashtu për finalizimin e paneleve të konferencës dhe pjesëmarrjen e panelistëve ndërkombëtarë.

Komiteti u informua mbi procesin zgjedhor për anëtarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv, për të cilin janë paraqitur katër kandidatura nga Azerbajxhani, Gjermania, Zelanda e Re dhe Afrika e Jugut. Procesi i votimit elektronik do të jetë gjatë periudhës 27 gusht – 27 shtator 2026. Një tjetër pikë e rëndësishme e rendit të ditës ishte shqyrtimi i aplikimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës për organizimin e Konferencës ICIC 2028.



Komiteti vendosi ngritjen e një paneli vlerësues që do të shqyrtojë aplikimin dhe do të paraqesë rekomandimet përkatëse.

Në kuadër të përmirësimit të strukturave të ICIC, Komiteti miratoi mbylljen e Grupit të Punës për Trajnimet, për shkak të mungesës së aktivitetit, si dhe diskutoi mbi zhvillimet lidhur me Memorandumin e Mirëkuptimit me UNESCO, për të cilin është parashikuar një ceremoni nënshkrimi gjatë konferencës së ICIC.

Gjithashtu, u miratua një format i ri për raportimet rajonale, i cili do të orientohet drejt zhvillimeve dhe prioritetëve strategjike në nivel rajonal, duke kontribuar në një koordinim më efektiv.

Në cilësinë e Sekretariatit të ICIC, Zyra e Komisionerit zhvilloi edhe mbledhjen përfundimtare të Komitetit të Planifikimit, e fokusuar në finalizimin e agjendës dhe koordinimin e aspekteve organizative të konferencës.



Kosova forcon rolin e saj në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të transparencës

Presidenti i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit dhe Aksesin në Informacion (ICIC), njëherazi Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Shqipërisë, z. Besnik Dervishi, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare të organizuar në Prishtinë me rastin e 15-vjetorit të Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe 5-vjetorit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Republikës së Kosovës.

Në fjalën e tij, Komisioneri Dervishi vlerësoi rrugëtimin institucional të Agjencisë, duke theksuar se ajo është shndërruar në një institucion kyç në garantimin e dy të drejtave themelore: të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Në cilësinë e Presidentit të ICIC, ai evidentoi rolin gjithnjë e më aktiv të Kosovës në strukturat ndërkombëtare të transparencës, duke veçuar kontributin e Agjencisë në grupet e punës të ICIC, drejtimin e Grupit të Punës për Integritetin e Informacionit, si dhe përfaqësimin në Komitetin Ekzekutiv të Rrjetit Evropian për Transparencë dhe të Drejtën e Informimit.

Komisioneri Dervishi theksoi se rajoni ynë nuk është më vetëm përfitues i standardeve ndërkombëtare, por po kontribuon gjithnjë e më shumë në formësimin e tyre. Ai e cilësoi këtë angazhim si dëshmi të besimit që komuniteti ndërkombëtar i autoriteteve të informimit po i kushton Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës, duke vlerësuar kontributin e saj në avancimin e standardeve të transparencës dhe aksesit në informacion.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:

